

TRASHËGIMIA KULTURORE NË

FO KU S.

TRASHËGIMIA KULTURORE NË SHQIPË

TRASHËGIMIA
KULTURORE NË **FO
KU
S.**



BOTIMI I TEKSTEVE BURIMORE
MBI PRAKTIKAT E RUAJTJES DHE
MENAXHIMIT TË TRASHËGIMISË
KULTURORE NË GJUHËN SHQIPE

Titulli: “Trashëgimia Kulturore në Fokus: Botimi i teksteve burimore mbi praktikat e ruajtjes dhe menaxhimit të trashëgimisë kulturore në gjuhën shqipe”

Botimi është mundësuar nga “Trashëgimia Kulturore pa Kufij Shqipëri” (Cultural Heritage without Borders Albania (CHwB Albania) me mbështetjen financiare të Suedisë nëpërmjet Agjencisë Ndërkombëtare për Zhvillim.

Përkthimet nga origjinali: Të ndryshëm referuar në çdo dokument përkatësisht

Redaktoi: Boiken Abazi

Parathënie për botimin nga: Elena Mamani, Lorenc Bejko dhe Boiken Abazi

Koordinoi procesin e përkthimeve dhe publikimit:

Elena Mamani, Regina Vathi, Pezana Rexha

Foto: © Bjori Thana, Regina Vathi

Dizajni: Ina (Hina) Shkëmbi, Joniz Osmanagaj

© CHwB Albania © ICOMOS Albania

Viti i botimit: 2023

196 f.: me foto ; 21 x 21 cm

ISBN: 9789928801081

1.Pasuria kulturore 2.Ruajtja dhe restaurimi 3.Menaxhimi 4.Shqipëri

904 :72 .03(496.5)

Shtëpia Botuese: “Graphic Line-01”



This work is distributed under the Creative Commons BY-NC-ND 4.0 licence, which enables re-users to copy and distribute the material in any medium or format in non-adapted form only, for non-commercial purposes only, and only so long as attribution is given to the creator.

Ky botim publikohet bazuar në licencën nga “Creative Commons BY-NC-ND 4.0”, e cila u mundëson ripërdoruesve të kopjojnë dhe shpërndajnë materialin në çdo mënyrë komunikimi ose format, por vetëm duke mos kryer përshtatje të formës, duke mos e përdorur për qëllime tregtare, si dhe për aq kohë sa i jepet krijuesit atributi përkatës.

DEKLARATA E PARISIT MBI TRASHËGIMINË SI MOTOR ZHVILLIMI

Miratuar në Paris, selia e UNESCO-s,
e enjte më 1 dhjetor 2011.

ICOMOS

Përkthyer nga: Iris Pojani.
Redaktuar nga: Boiken Abazi.

Versioni origjinal ©ICOMOS. Ky përkthim nuk është përkthim zyrtar ICOMOS-it. Ky përkthim në gjuhën shqipe botohet me lejen e ICOMOS-it, por nën përgjegjësinë e vetme të përkthyesit/botuesit.

PARATHËNIE

1150 pjesëmarrës nga 106 vende u mbledhën në Paris nga data 28 nëntor deri më 1 dhjetor 2011, në selinë e UNESCO-s në Francë me ftesë të ICOMOS-it në Francë, me rastin e Asamblesë së Përgjithshme të 17-të të Këshillit Ndërkombëtar për Monumentet dhe Sitet (ICOMOS), dhe miratuan këtë Deklaratë për parimet dhe rekomandimet mbi marrëdhëniet ndërmjet trashëgimisë dhe zhvillimit, e cila duhet parë si një vlerë e shtuar për konservimin e trashëgimisë, për përhapjen e vlerave të saj të qenësishme dhe për zhvillimin kulturor, social dhe ekonomik të komuniteteve. Kjo Deklaratë dhe rekomandimet e saj i drejtohen palëve të interesit që janë të përfshira në konservimin e trashëgimisë, zhvillimin dhe turizmin, dhe më specifikisht Shteteve, autoriteteve lokale, institucioneve ndërkombëtare, në veçanti agjencive të Kombeve të Bashkuara dhe UNESCO-s ashtu si dhe organizatave përkatëse të shoqërisë civile.

Kjo Deklaratë është pjesë e një sërë nismave dhe veprimeve që janë ndërmarrë nga ICOMOS-i përgjatë shumë viteve, me qëllim promovimin e një procesi zhvillimor që përfshin trashëgiminë kulturore materiale dhe jomateriale si një aspekt jetik i qëndrueshmërisë, i cili e vesh zhvillimin me një pamje njerëzore. Vlen të përmendet në veçanti konferenca e ICOMOS-it e mbajtur në Moskë dhe Suzdal, në Rusi (1978), me temën "Mbrotjtja e qyteteve dhe lagjeve historike në kuadrin e zhvillimit urban". Një nga nëntemat e saj ishte "Monumentet historike si një mbështetje për zhvillimin ekonomik dhe social", që tregon se 33 vite më parë organizata jonë kishte filluar tashmë të reflektonte mbi marrëdhëniet midis trashëgimisë dhe zhvillimit. Kjo temë u hulumtua më tej në simpoziumin shkencor të titulluar "No Past, No Future" (Pa të shkuarën, s'ka të ardhme) të mbajtur gjatë Asamblesë së gjashtë të Përgjithshme të ICOMOS-it në Itali, dhe simpoziumit shkencor të titulluar "The Wise Use of Heritage" (Përdorimi i trashëgimisë me mençuri) i mbajtur në Meksikë, në vitin 1999. Puna dhe raportet në Nara (1997), Xi'an (2005) dhe Quebec (2008), ndihmuan në zhvillimin e koncepteve të trashëgimisë, si 'autenticiteti', 'konteksti' dhe 'fryma e vendit'. Një hap i rëndësishëm ka qenë puna e ICOMOS-it në zhvillimin e Kartave që janë bërë standarde ndërkombëtare, veçanërisht për UNESCO-n dhe shtetet anëtare të saj. Me rëndësi të veçantë janë Karta Ndërkombëtare e Turizmit Kulturor e ICOMOS-it, e hartuar në vitin 1977 dhe e përditësuar në vitin 1999, Karta e ICOMOS-it për Shtigjet (Itineraret) Kulturore, e miratuar

nga ICOMOS-i në vitin 2008, dhe Karta e ICOMOS-i për Interpretimin dhe Prezantimin e Siteve të Trashëgimisë Kulturore, e cila u miratua gjithashtu në vitin 2008.

Pse kjo temë?

Efektet e globalizimit mbi shoqëritë në botë shpërfaqen përmes tretjes së vlerave, identiteteve dhe larmisë kulturore të tyre, si dhe të trashëgimisë materiale dhe jomateriale të tyre – në kuptim më të gjerë. Për këtë arsye duhet të analizohet marrëdhënia midis zhvillimit dhe trashëgimisë.

Shqetësimet që sillen rreth trashëgimisë dhe zhvillimit janë pasqyruar gjithashtu në temën që UNESCO-ja ka zgjedhur për të kremtuar 40-vjetorin e Konventës së Trashëgimisë Botërore në Kioto, në vitin 2012: "Trashëgimia Botërore dhe zhvillimi i qëndrueshëm: roli i komuniteteve vendase".

Kjo temë synon fillimisht të vlerësojë efektet e globalizimit në komunitete dhe trashëgimi. Më pas, synon identifikimin e veprimeve që nevojiten jo vetëm për të mbrojtur trashëgiminë, por edhe për t'u siguruar se përdorimi, promovimi dhe përmirësimi, si dhe vlera e saj ekonomike, sociale dhe kulturore shfrytëzohen në dobi të komuniteteve dhe vizitorëve vendas. Së fundi, ajo synon të vlerësojë aftësinë e trashëgimisë dhe vlerat e saj të qenësishme për të frymëzuar dhe ndërtuar shoqëritë e së nesërme, duke zbutur efektet negative të globalizimit.

Përballja me sfidën

Ndërkohë që aspekte të ndryshme të zhvillimit rrezikojnë ta degradojnë dhe shkatërrojnë trashëgiminë dhe vlerat e saj të qenësishme, është e nevojshme të përballesh me sfidën e konservimit të kësaj pasurie të brishtë, vendimtare dhe të parinovueshme, për të mirën e brezave të sotëm dhe të ardhshëm.

Tashmë është pranuar gjerësisht se trashëgimia përbën një aspekt thelbësor të procesit të zhvillimit – me vlerën e saj në lidhje me identitetin, dhe si një arkivë e kujtesës historike, kulturore dhe sociale, e ruajtur përmes autenticitetit, integritetit dhe "domethënies së vendit".

Sfida për integrimin e trashëgimisë, dhe marrja e masave që sigurojnë se ajo do luajë rolin e saj në kontekstin e zhvillimit të qëndrueshëm, është mënyra e dëshmitit se si trashëgimia kontribuon në kohezionin social, mirëqenien, krijimtarinë dhe mundësitë ekonomike, ashtu si dhe kontributi që ajo jep si faktor në nxitjen e mirëkuptimit ndërmjet komuniteteve.

Nën dritën e mbi 150 punimeve dhe debateve të frymëzuara nga pjesëmarrësit, ata dëshmuar se si trashëgimia, në kuptimin më të gjerë të fjalës, mund të japë kontribute të vlefshme dhe të ofrojë udhëzime të gjera dhe konstruktive në trajtimin e çështjeve që lidhen me zhvillimin. Përmes Deklaratës së Parisit, këto kontribute janë pasqyruar së bashku në parimet dhe rekomandimet që Asambleja e Përgjithshme dëshiron të sjellë në vëmendjen e Shteteve, si dhe nëpërmjet tyre edhe në vëmendjen e komunitetit ndërkombëtar.

Kultura, shtylla e katërt e zhvillimit të qëndrueshëm

Samiti Botëror i Johannesburgut për Zhvillimin e Qëndrueshëm (2002), e njohu larminë kulturore si shtyllën e katërt të zhvillimit të qëndrueshëm, krahas shtyllave ekonomike, sociale dhe mjedisore. Në Nenin 3 të Deklaratës Universale të UNESCO-s për larminë kulturore (2001), përkufizimi i zhvillimit korrespondon përfafërsisht me rolin që ne do të donim t'i jepnim trashëgimisë në procesin e zhvillimit – interpretuar në kuptimin e tij më të gjerë: “zhvillimi, i kuptuar jo vetëm në termat e rritjes ekonomike, por edhe si mjet për të arritur një ekzistencë më të kënaqshme intelektuale, emocionale, morale dhe shpirtërore”.

Rezoluta 65/166 mbi Kulturën dhe Zhvillimin, e miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara në shkurt të vitit 2011, siç u deklarua edhe nga Drejtori i Përgjithshëm i UNESCO-s, ka rritur më tej ndërgjegjësimin për rolin e spikatur që kultura luan në zhvillim, duke vënë në dukje “...se kultura [ku bën pjesë edhe trashëgimia] është një komponent thelbësor i zhvillimit njerëzor ... që siguron rritjen ekonomike dhe zotërimin e proceseve të zhvillimit”.

DEKLARATA E SIMPOZIUMIT

Pjesëmarrësit e Asamblesë së 17-të të Përgjithshme ia drejtojnë këtë Deklaratë organizatave ndërqeveritare, autoriteteve kombëtare dhe vendore, si dhe të gjitha institucioneve dhe specialistëve, dhe rekomandojnë veprimet e mëposhtme:

1. TRASHËGIMIA DHE ZHVILLIMI RAJONAL.

Kontrolli dhe rishpërndarja e zhvillimit urban.

- Të ruhen zonat historike dhe të inkurajohet restaurimi dhe rigjenerimi i tyre;

- Të zhvillohet dhe drejtohet puna që lidhet me rigjenerimin dhe rritjen e densitetit urban, duke promovuar një përçasje harmonike, të ekuilibruar dhe koherente për paraqitjen e rrugëve dhe parcelave, peizazheve të rrugëve, densitetit dhe lartësisë së zhvillimeve urbane, si dhe rikuperimit të djerrinave urbane dhe zonave urbane periferike, me qëllim rikrijimin e lagjeve urbane shumëfunktionale me një peizazh të ndërtuar urban; duke restauruar konceptin e kufijve urbanë.
- Të promovohet planifikimi dhe zhvillimi i ekuilibruar për të siguruar shpërndarjen më të përshtatshme të zonave të aktiviteteve, duke përfshirë objektet arsimore, kulturore, turistike dhe ato për kalimin e kohës së lirë.

Rijetëzimi i qyteteve dhe ekonomive lokale

- Të inkurajohen ruajtja dhe ripërdorimi selektiv i trashëgimisë së ndërtuar në qytete dhe fshatra, në mënyrë që të nxitet rigjenerimi socio-ekonomik; për të rritur densitetin e bërthamave urbane dhe për të frenuar përhapjen anarkike të ndërtesave të reja;
- Të mbështet mirëmbajtja e aktiviteteve tradicionale bujqësore dhe zejtare për të ruajtur aftësitë dhe ekspertizën, si dhe për të ofruar punësim për komunitetet vendase;
- Të mirëmbahen dhe të risillen në përdorim në nivel lokal teknikat e qëndrueshme tradicionale të prodhimit të energjisë, si dhe të zhvillohen burime të reja të prodhimit të saj, duke patur për synim sigurinë ekonomike dhe energjetike.

Ruajtja e hapësirës

- Të ruhen ambientet e hapura që nuk janë të rinovueshme; të mirëmbahen peizazhet rurale dhe organizimi dhe niveli i bujqësisë dhe pyjeve të tyre; të konservohet trashëgimia bimore dhe ujore autoktone; të mbrohet trashëgimia gjeologjike dhe arkeologjike, ujërat nëntokësore dhe ekosistemet;
- Të mirëmbahen rrjetet e komunikimit rajonal dhe lokal (trashëgimia hekurudhore, rrugët, rrugët e lundrueshme ujore) për të transportuar njerëz dhe mallra, si dhe për të siguruar ofrimin e shërbimeve lokale; të promovohen mënyrat alternative të transportit;
- Të ruhet trashëgimia rurale përmes ripërdorimit

të duhur të saj, duke ruajtur integritetin e shpërndarjes hapësinore dhe elementeve funksionale; të kufizohet rreptësisht shtrirja urbane dhe të vendosen kritere për të drejtën e ndërtimit, duke përcaktuar se zhvillimi duhet të respektojë peizazhin historik dhe modelet tradicionale të vendbanimeve.

2. NJË KTHIM TE ARTI I NDËRTIMIT

Konservimi

- Të ruhet trashëgimia e ndërtuar, qoftë urbane apo rurale, prestigjioze apo popullore, dhe që është e cilësisë së lartë, si dhe të ruhen materialet origjinale, kompozimi dhe ndërtimi, arkitektura, mirëmbajtja e funksioneve origjinale dhe të kryhet integrimi me mjedisin fizik dhe socio-kulturor;
- Të përshtaten përdorimet dhe funksionet e reja me trashëgiminë ekzistuese, dhe jo anasjelltas, si dhe të ndihmohen përdoruesit e ndërtesave historike të përshtasin pritshmëritë e tyre lidhur me standardet moderne të jetesës;
- Të merret parasysh se 'trashëgimia arkitektonike dhe ajo e peizazheve është unike, dhe si e tillë mund të kërkojë fleksibilitet në zbatimin e standardeve dhe rregulloreve që nuk i përbushin nevojat e saj. Duhet të vendoset menjëherë një moratorium për të marrë njëherë këshillat e ekspertëve dhe specialistëve, dhe moratoriumi duhet të vazhdojë deri sa ata të kenë zhvilluar një përqasje specifike dhe të përshtatshme, si dhe deri në miratimin e masave kalimtare.' (ICOMOS - Paris, nëntor 2000);
- Të rikthehen aftësitë tradicionale të ndërtimit dhe praktikat më të mira, si dëshmi e kompetencës për të ndërmarrë punime restauruese;
- Të përshtaten metodat e vlerësimit të funksionimit dhe analizës së strukturave, si dhe të vetive termike dhe sigurisë në pëputhje me nevojat e trashëgimisë, dhe jo anasjelltas;
- Të merren masat e nevojshme për të siguruar që në kushte normale dhe të sigurta pune do të vijojë prodhimi i materialeve tradicionale të ndërtimit, dhe do të përdoren në mënyrë të përshtatshme mjetet tradicionale në restaurimin e strukturave historike.

Arkitekturë novatore frymëzuese

- Ndërtesat historike tradicionale janë një thesar i përvojës arkitektonike. Ato janë një burim i pashtershëm universal frymëzimi për arkitekturën moderne dhe novator për sa i përket materialeve, metodave të ndërtimit, planimetrisë dhe projektimit, duke kontribuar në një cilësi të lartë jetese.

3. TURIZMI DHE ZHVILLIMI

Trashëgimia dhe sfida e turizmit: cilat strategji, çfarë mjetesh?

- Të rritet ndërgjegjësimi dhe të ndërtohen kapacitete për profesionistët e konservimit dhe menaxherët e sitit në mënyrën e duhur, për të adresuar çështje që lidhen me turizmin dhe zhvillimin; të rritet ndërgjegjësimi në lidhje me brishtësinë dhe vlerën e trashëgimisë mes profesionistëve të turizmit, operatorëve turistikë, si dhe kompanive të hotelarisë dhe lundrimit.
- Të përfshihen të gjitha palët e interesit në hartimin e planeve të menaxhimit për sitet e trashëgimisë, destinacionet turistike, si dhe qendrat dhe rajonet urbane, duke adresuar pyetjet e mëposhtme: çfarë lloj turizmi, për kë dhe për cilën arsye? Të zhvillohen plane menaxhimi që bazohen në vlerat specifike kulturore, historike, mjedisore, estetike dhe të kujtesës që duhet ruajtur mbi "frymën e vendit", si dhe mbi një vizion afatgjatë për zhvillimin e qëndrueshëm të turizmit, me të cilin pajtohen të gjitha palët e interesit.
- Të zhvillohen mjetet e menaxhimit për mbledhjen e të dhënave mbi turizmin, vlerësimin e rolit të trashëgimisë dhe përmirësimin e këtij roli në kuadër të zhvillimit të turizmit; të vlerësohen kostot e degradimit të vlerave dhe pasurive të trashëgimisë; të sigurohet ruajtja afatgjatë e pasurive kulturore dhe ekonomike; të inkurajohen vlerësimet e ndikimit në trashëgimi, turizëm dhe zhvillim; të zhvillohen trajnime në menaxhimin e përgjegjshëm të turizmit. Përveç kësaj, të vendosen metoda për të arritur shpërndarjen e drejtë të të ardhurave që nxirren nga turizmi që lidhet me trashëgiminë, duke marrë parasysh koston e konservimit

dhe menaxhimit të trashëgimisë, komunitetet vendase dhe kompanitë turistike lokale, kombëtare dhe ndërkombëtare.

A mund të jetë i qëndrueshëm zhvillimi i turizmit?

- Të lidhet dhe integrohet konservimi dhe ruajtja e trashëgimisë me thelbin e zhvillimit të turizmit kulturor. Të ruhen burimet kulturore si një pasuri themelore e zhvillimit afatgjatë të turizmit, veçanërisht në vendet në zhvillim dhe ato më pak të zhvilluara.
- Të vendoset autenticiteti në qendër të zhvillimit të turizmit kulturor dhe të strategjive të interpretimit dhe komunikimit; të promovohet interpretimi bazuar në hulumtime dhe inventarë të mirë, duke shmangur sajimin e “udhëtimeve në hiper-realtitet” që derivojnë në mënyrë të papërpunuar nga vlerat e trashëgimisë.
- Të ndihmohen komunitetet vendase të marrin përgjegjesi në lidhje me trashëgiminë e tyre dhe projektet turistike të lidhura me të. Të inkurajohet fuqizimi dhe pjesëmarrja e tyre në konservimin e trashëgimisë, procesin e planifikimit dhe në vendimmarrje. Pjesëmarrja lokale që mbështetet në perspektivat, prioritetet dhe njohuritë lokale është një parakusht i zhvillimit të qëndrueshëm të turizmit.

Inkurajimi i komuniteteve vendase për të marrë përgjegjesi mbi zhvillimin e trashëgimisë dhe turizmit

- Të edukohen të rinjtë – veçanërisht në shkollë – dhe më gjerë popullata në lidhje me trashëgiminë dhe vlerat e saj të qenësishme historike, kulturore dhe sociale, që i japin kuptim dhe domethënie së shkuarës.
- Të përdoret mediat për përhapjen e njohurive rreth trashëgimisë, të cilat do të krijojnë një ndjenjë krenarie dhe dëshirë për t’u përfshirë në mbrojtjen dhe përmirësimin e saj.
- Të inkurajohet angazhimi i komuniteteve si palë interesi në sektorët e trashëgimisë kulturore dhe turizmit, dhe të nxitet krijimtaria, zhvillimi personal dhe shpirti sipërmarrës.
- Të inkurajohet dialogu ndërmjet komuniteteve vendase/autoktone dhe vizitorëve për të kontribuar në shkëmbimin kulturor, përhapjen e vlerave sociale, kulturore dhe njerëzore të

trashëgimisë dhe për t’i interpretuar ato në një mënyrë të saktë shkencore, historike dhe shoqërore.

4. TRASHËGIMIA DHE EKONOMIA

Nxitja e një kuptimi më të mirë mbi ndikimin ekonomik të konservimit të trashëgimisë

- Të kuptohet më mirë ndikimi ekonomik dhe social në rritjen maksimale të vlerës së trashëgimisë, e cila i kontribuon zhvillimit;
- Të krahasohen hulumtimet ekzistuese, të ndërmerren studime të mëtejshme të detajuara në bashkëpunim me institucionet përkatëse si dhe të përhapen gjerësisht rezultatet;
- Të zhvillohen hulumtime mbi kontributin e trashëgimisë në zhvillimin e qëndrueshëm dhe mbi marrëdhëniet ndërmjet investimeve dhe zhvillimit; të studiohen marrëdhëniet ndërmjet trashëgimisë, krijimtarisë dhe zhvillimit, si dhe të identifikohen treguesit e rendimentit;
- Të merret në konsideratë mënyra se si trashëgimia e shumanshme mund të menaxhohet më së miri për t’ia përcjellë brezave të ardhshëm, dhe të sigurohet kontributi i saj në zhvillimin e shoqërive dinamike dhe në lëvizje.

Promovimi i ndikimeve afatgjata të trashëgimisë në zhvillimin ekonomik dhe kohezionin social

Studimet tregojnë se trashëgimia mund të jetë një mjet në zhvillimin rajonal, por nuk është përdorur në mënyrë të vazhdueshme: ajo duhet të bëhet objektivi i politikave zhvillimore;

- Të vendosen njerëzit në qendër të synimeve të politikave dhe projekteve; të vihet në pah se përgjegjësia mbi trashëgiminë forcon strukturën sociale dhe rrit mirëqenien sociale; të përfshihen komunitetet vendase në një fazë shumë të hershme të propozimeve për zhvillim dhe përmirësim; të rritet ndërgjegjësimi, veçanërisht tek të rinjtë; të zhvillohen trajnime për profesionistët;
- Të merren parasysh efektet e drejtpërdrejta, përfitimet nga turizmi dhe avantazhet financiare të trashëgimisë, për të rritur krijimtarinë e rajoneve dhe për t’i bërë ato sa më tërheqëse; të bëhet kujdes që nevojat e domosdoshme

ekonomike të respektojnë ato të konservimit të trashëgimisë materiale dhe jomateriale; të merren masa për t'u siguruar veçanërisht që nga të ardhurat ekonomike të trashëgimisë të përfitojë së pari mirëmbajtja dhe përmirësimi i saj, si dhe komuniteti vendas;

- T'i kushtohet vëmendje e veçantë restaurimit të trashëgimisë urbane dhe industriale, veçanërisht në qendrat historike dhe kryesore të qyteteve, si një mënyrë për të luftuar varfërinë në vendet në zhvillim.

Zhvillimi i ndikimit ekonomik të trashëgimisë

- Të merren masa për t'ia kujtuar autoriteteve publike se janë rojtarët e interesit publik dhe janë përgjegjës për mbrojtjen ligjore të trashëgimisë përballë presionit që vjen në lidhje me përdorimin e tokës; t'i jepet përparësi procesit të restaurimit në vend të shkatërrimit të trashëgimisë;
- Të vendoset trashëgimia në qendër të strategjive të përgjithshme të zhvillimit, duke vendosur synime për përfitimet ekonomike dhe sociale për t'u siguruar që zhvillimi i trashëgimisë të shpërblejë komunitetet vendase në aspektin e punësimit, rrjedhës së financave dhe mirëqenies; industritë kulturore dhe ato të krijimtarisë dhe artizanatit që lidhet me përmirësimin e pasurive të trashëgimisë kontribuojnë në përmirësimin e kushteve të jetesës;
- Të zbatohen politikat për mbrojtjen, planifikimin, financimin dhe menaxhimin, të përshtatura me kalimin e kohës, në mënyrë që ndryshimi të respektojë autenticitetin e trashëgimisë dhe të kontribuojë në zhvillimin e qëndrueshëm; të këmbahet përvoja mbi praktikën më të mirë.

5. PALËT E INTERESIT DHE NGRITJA E KAPACITETEVE

Roli i komuniteteve vendase dhe rritja e ndërgjegjësimit të palëve të interesit

Popullata vendase, shoqëria civile dhe zyrtarët e zgjedhur vendorë dhe kombëtarë do të luajnë një rol kyç në hartimin dhe zbatimin e rolit të trashëgimisë si motor zhvillimi, dhe nëpërmjet rritjes së ndërgjegjësimit mbi trashëgiminë ata do të kenë përgjegjësi mbi procesin e zhvillimit. Fushatat informuese për të rritur ndërgjegjësimin do t'i mundësojnë shoqërisë civile të njohë dhe të marrë përgjegjësi mbi trashëgiminë dhe t'i shfrytëzojë këto vlera drejt zhvillimit të qëndrueshëm.

Trajnimi profesional

Palët kryesore të interesit në konservimin e trashëgimisë me synim zhvillimin kanë nevojë për trajnim dhe ngritje kapacitetesh, duke përfshirë arkitektë, konservues, menaxherë të trashëgimisë, planifikues të zhvillimit, investitorë dhe operatorë turistikë.

Kuadri ligjor

Mbrojtja e trashëgimisë në kontekstin e zhvillimit përfshin gjithashtu krijimin dhe rishikimin e vazhdueshëm të kornizave institucionale dhe ligjore në nivel vendor, kombëtar dhe ndërkombëtar (Konventa e Trashëgimisë Botërore). Mbi të gjitha, është e nevojshme që këto korniza të zbatohen në terren. Ato do të përfshijnë konsultimin, duke ndjekur procedurat e qeverisjes demokratike dhe planifikimit me pjesëmarrje, duke nxitur një nivel të mirë kuptueshmërie dhe pranimitë që do të ndihmonte në zbatimin efektiv të tyre.

Puna kërkimore

Institutet kërkimore, universitetet, organizatat eksperte këshillimore si ICOMOS-i, dhe organizatat ndërqeveritare si UNESCO-ja, duhet të forcojnë programet dhe studimet e tyre kërkimore. Këto nisma do të përfshijnë monitorimin në terren të mjeteve analitike të përdorura për të vlerësuar funksionalitetin fizik të trashëgimisë së ndërtuar, matjen e vlerës ekonomike të trashëgimisë, vlerësimin e ndikimit të turizmit kulturor në punësimin dhe pasurinë rajonale, si dhe hulumtimin e kushteve, rreziqeve dhe mundësive të investimit në mbrojtjen e trashëgimisë, duke bashkuar partnerët e zhvillimit ekonomik dhe financiar.

Bashkëpunimi

ICOMOS-i mund të forcojë bashkëpunimin dhe partneritetin e tij me institucionet kombëtare dhe ndërkombëtare që punojnë në fushën e trashëgimisë dhe zhvillimit, duke përfshirë UNESCO-n. ICOMOS-i është i përfshirë në mënyrë aktive në Programin e Turizmit të Trashëgimisë Botërore të UNESCO-s dhe në Rekomandimin e UNESCO-s mbi marrëdhëniet midis konservimit të trashëgimisë dhe turizmit të qëndrueshëm.